[Shqiptarja.com]
E diel 4 Qershor 2023 - Përditësimi i fundit 12:36
Kërko
LIVE Shqiptarja.tv
HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION
TË FUNDIT SOCIALE ORËJTI PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PRKË E ZEZË SONDAZHE
POP 5 Lajmet dhe fotografitë e fundmja të ditës
1 Mbyti të dërmë me qese plastike djalin e mashtroi se Pëllumb Çe disen ajo çfaqi dhunë ndaj fëmijës, kishte shoqërimet Gazetat e dhanë emër
2 E mudi në Fërmet, 24 kërcënime me plasmasa-vendi e tij Bazë. Ku burg Ashmi M Gjatë diskut, ja çfa bëri
3 Mashtroi pjesëmarrës pranë prindërve duke premtuar 5 mln-ero, kush kishte 40 mln-ëshëm ne ujesitë nga policia ndë Korçë
4 Dashuria duhet të synojë mundësi, ja si Zaklina dëmtoca bisedës me partnerëne që çdo marrëdhënie të ziguar
5 Si krijë marrëdhënie me djalin tuaj që mundi Okashkiar me Gonzalezi? Ve kët fëmi për një partnerësi

Kronikë

Plagosi me thikë 2 persona në Sarandë, pas rreth 5 orësh në arrati, vihet në pranga autori! I arrestuar 3 herë më parë për drogë dhe armë (EMRAT)

Një 52-vjeçar i identifikuar si Fatmir Jashari është arrestuar pas rreth 5 orësh në kërkim për plagosjen me thikë të dy personave.

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
Qendrimet

Redaksia
3 Qershor, 15:23 / Përditësimi: 3 Qershor, 19:51

Ndaj

SARANDË – Një 52-vjeçar i identifikuar si Fatmir Jashari është arrestuar pas rreth 5 orësh në kërkim për plagosjen me thikë të dy personave. Ni banesë iu gjetën një sasi municioni luftarak dhe një sasi lëndë plasëse artizanale, që u sekuestruan në çilësinë e provës materiale.

Ngjarja ka ndodhur rreth orës 14.00, në lagjen nr.2, Sarandë, ku dyshohet se pas një konflikti për motive të dobëta, Jashari ka plagosur me mjet prerës (thikë), Edmond Sulon 54 vjeç dhe Spiro Llambiro 62 vjeç, të dy banues në Sarandë. Dy të dëmtuarit ndodhen në spital, jashtë rrezikut për jetën. Bëhet me dije se Edmond Sulo është qëllëuar me thikë në kokë dhe poshtë sqetullës.

LEXO EDHE:
VIDEO/ Përfshihet nga flakët banesa në Vlorë, shkrumbohet totalisht

Shërbimet e Policisë kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe janë vënë në ndjekje të autorit të dyshuar, me qëllim kapjen e tij.

Fatmir Jashari rezulton të jetë një emër i njohur për policinë pasi është arrestuar 3 herë për armë dhe drogë. Mësohet se Jashari është arrestuar më herët në vitin 2000 në Korfuz nën drejtimin e një skafi me të cilin kryente trafik drogë, ngjarje për të cilen u dënua 2 vite burg. Më pas është arrestuar në vitin 2009 nga policia e Gjirokastrës me një sasi prej 50 kg kanabis, por u lirua pas disa muajsh. Arrestuar në vitin 2013 në Sorone, Bashkia Konispol me 240 kg kanabis.

Grupi hetimor ndodhet në vendngjarje dhe nën drejtimin e Prokurorisë dhe po punon për sqarimin dhe zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes së ndodhur ditën e sotme.

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 19:44

VIDEO/ Plagosja me thikë e 2 personave në Sarandë, arrestohet pas rreth 5 orësh autori! Në banesë kishte municion luftarak dhe sasi lëndë plasëse

Një 52-vjeçar i identifikuar si Fatmir Jashari është arrestuar pas rreth 5 orësh në kërkim për plagosjen me thikë të dy personave.

Njoftimi i plotë

Sarandë/Plagosi me mjet prerës (thikë), 2 shtetas, gjatë një konflikti për motive të dobëta, falë reagimit në kohë të Policisë, kapet dhe vihet në pranga 52-vjeçari, autori i dyshuar. Sekuestrohen një sasi municioni luftarak dhe një sasi lëndë plasëse artizanale, që u gjetën në banesën e autorit të dyshuar.

Sot, rreth orës 14.00, në lagjen nr. 2, Sarandë, dyshohet se pas një konflikti për motive të dobëta, shtetasi F. J., 52 vjeç, ka plagosur me mjet prerës (thikë), shtetasit E. S., 54 vjeç dhe S. Ll., 62 vjeç, të dy banues në Sarandë, të cilët ndodhen në spital, jashtë rrezikut për jetën.

Si rezultat i veprimeve të shpejta dhe profesionale nga Policia, u bë e mundur kapja dhe shoqërimi në ambientet e Komisariatit të Policisë Sarandë, i autorit të dyshuar të ngjarjes, shtetasit F. J. Në vijim të veprimeve, shtetësimet e Policisë, gjatë kontrollit në banesën e 52-vjeçarit, gjetën dhe sekuestruan një sasi lëndë të dyshuar nitrat amoni, që përdoret si lëndë plasëse artizanale, 16 kapsolla detonatore dhe 3 fishekë luftarakë.

Në përfundim të veprimeve procedurale, nga specialistët për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Sarandë u bë arrestimi në flagrancë i shtetasit F. J., 52 vjeç, për veprat penale "Plagosja e rendë me dashje" dhe "Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit".

Materialet procedurale do t'i kalojnë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për veprime të mëtejshme.

Ora 15:02

FOTO/ Plagosi me thikë 2 persona në Sarandë, ky është 52 vjeçari i shpallur në kërkim! I arrestuar 3 herë për drogë dhe armë

Ky është Fatmir Jashari, i njohur me pseudonimin "Radan" i cili plagosi me thikë 2 persona ditën e sotme. 52 vjeçari i shpallur në kërkim, është person me precedentë penalë dhe mësohet se më herët është arrestuar 3 herë për vepra të ndryshme penale.

Mësohet se është arrestuar më herët në vitin 2000 në Korfuz nën drejtimin e një skafi me të cilin kryente trafik drogë, ngjarje për të cilen u dënua 2 vite burg. Arrestuar në vitin 2009 nga Policia e Gjirokastrës me një sasi prej 50 kg kanabis, por u lirua pas disa muajsh. Arrestuar në vitin 2013 në Sorone, Bashkia Konispol me 240 kg kanabis.

Gjate kontrollit te banesës së Fatmir Jasharit në 2009 u gjetën 3 zjarri automatike tip Kallashnikov, 2 kilogramë tritol, 680 kapsolla detonatore, ku 50 copë ishin të montuara me fjesë teli, 50 metra fitil ndezës, 1500 fishekë model 56 (automatiku) dhe 6 krehëra automatiku me fishekë.

Ndërsa në vitin 2013 nëe automjetin qe u kap me drogën /u gjet 1 Kallashnikov ndeërsa nëe baneseë disa kapsolla detonatorë.

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Sarandë Vlorë Edmond Sulo Fatmir Jashari Spiro Llambiro

Komento

Ndalohet riprodhimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2014

SH
Sondazhi i ditës:
Arrestimi i zyrtares së Shëndetësisë, a po e lufton SPAK korrupsionin?
Po Jo Nuk e di

Lajme te tjera

Vlorë, zbulohet projekti që do ndërtohet në zonën e Skelës ku dy ditë më parë u shemb ndërtesa dy katëshe në të cilën jetonin 7 familje
2 Qershor, 21:08

Aksident në rrugën transbalkanike në Vlorë, 'Benz'-i përplaset me një makinë të parkuar! Plagoset pasagjerja
3 Qershor, 19:20

FOTO/ Plagosi me thikë 2 persona në Sarandë, ky është 52 vjeçari i shpallur në kërkim! I arrestuar 3 herë për drogë dhe armë
3 Qershor, 15:52

Apartamente, toka e llogari bankare, prokuroria e Vlorës sekuestroi 13 milionë euro asete brenda 2022
3 Qershor, 09:54

Bashkia i shembi shtëpinë, 63-vjeçarja protestë tek rrëmojat! Hoxhaj kundër vlerës së shpronësimit: Do futem në grevë urie!
Armand Xhelili
2 Qershor, 12:15

VIDEO/ Hipi në tarracë me të emën për të kundërshtuar shembjen e ndërtesës, e reja në Vlorë shoqërohet me forcë nga policia
1 Qershor, 10:55

Basha me të rinjtë në Vlorë, ironizon Berishën: Ku është revolucionin që do e rrëzonte për 6 muaj Ramën? Sjam béré pishman që e përjashtova
1 Qershor, 10:38

VIDEO/ Refuzuan vlerën e shpronësimit, nëna dhe vajza e saj në Vlorë hipin mbi tarracën e ndërtesës të planifikuar për t'u shembur nga IKMT
1 Qershor, 10:35

Ksamil/ Motori përplaset me makinën, video nga momenti i aksidentit
1 Qershor, 07:29

IKMT ka nisur shembjen e një objekti në Dhërmi, pronarja: E paligjshme, është në proces legalizimi
31 Maj, 13:01

Hotelet e Vlorës në krizë për punëtorë, Ceno: Paga për sanitare e kamerier 45 mijë lekë në muaj, por sërish s'ka interes
Armand Xhelili
30 Maj, 15:40

Po punonte në një pallat në ndërtim në Sarandë, vdes 50-vjeçari! Ra aksidentalisht nga lartësia
30 Maj, 13:17

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje